



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 12.11.2019

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
AKTIN FINAL TË KONFERENCËS SË SHTETEVE ANËTARE TË KONVENTËS
NDËRKOMBËTARE PËR STANDARDET E KUALIFIKIMIT, CERTIFIKIMIT DHE
SHËRBIMIT PËR DETARËT”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12 nëntor 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të Konferencës së Shteteve Anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët”.

Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishte i pranishëm z. Artan Shkreli, zv.ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Aktin final të Konferencës së Shteteve Anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e kualifikimit, certifikimit dhe shërbimit për detarët. Miratimi i këtij akti do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e standardeve kombëtare të nevojshme për trajnimin dhe kualifikimin e marinarëve të sotëm, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare. Dispozitat e aktit final do të jenë të detyrueshme jo vetëm për detarët por edhe për pronarët e anijeve, institucionet e trajnimit dhe administratat kombëtare detare.

Ndryshimet që janë parashikuar në Aktin Final të Konventës përditësojnë standardet veçanërisht në dritën e ndryshimeve teknologjike, prezantojnë kritere dhe metodologji të reja kualifikimi dhe atestimi, detajojnë kriteret e orëve të punës dhe të pushimit për detarët, parandalimin e abuzimit me drogë dhe alkool, përcaktojnë standardet e gjendjes shëndetësore të detarëve si dhe synojnë të përfshijnë metodologji dhe kërkesa të reja në lidhje me trajnimin në teknologjinë moderne.

Miratimi i projektligjit bëhet në zbatim të detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të IMO-së për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-**Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
-**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORI

Edmond LEKA

KRYETARI

Ulsi MANJA